

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Nr. i prot. 2023/ZDP/343
Br. prot./Prot.Nr. _____
Faqe: 2 Kopje: - Datë: 10/10/2023
Stranica/Pages _____ Kopija/Copy _____ Datum/Date _____
Hyrës/ulazno/in _____
Dalës/izlazno/out _____
Brendshëm/interno/internal _____
Prishtinë/Priština/Pristina

09/ZDP/VE/2023
Datë: 10 tetor 2023

Në mbështetje të nenit 15.1 (d) dhe (j), 37 dhe 39.1 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28, Viti III, datë 4 qershor 2008), ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, nenit 24 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 7, dt. 1 mars 20 19), në pajtim me Shtojcën II, Nën-pjesën D, piken ATCO.AR.D.005 të Rregullores (AAC) nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrolloreve të trafikut ajror,

Duke marrë për bazë rekomandimin e Departamentit të Shërbimit të Navigacionit Ajror lidhur me tërheqjen e revokimit të licencës me nr. CAA033, dt. 09 tetor 2023 me nr. prot. 2023/SHNA/341,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

V E N D I M

1. SHFUQIZOHET Vendimi 05/ADP/VE/2023 i dt. 07 qershor 2023, për revokimin e licencës nr. CAA033.
2. RI-LËSHOHET Licenca e kontrollorit të trafikut ajror me nr. CAA033, me të gjitha miratimet dhe gradimet e saj.
3. OBLIGOHET Departamenti i Shërbimeve të Navigacionit Ajror në përputhje me legjislacionin në fuqi të marrë të gjitha masat e nevojshme lidhur me zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Me datë 05 tetor 2023 Departamenti i SHNA-së ka pranuar email, ndërkaq me datë 09.10.2023 edhe Vendimin me nr. Prot. 2023/DSF/AMS/GEN/340 nga AMA, përmes të cilit njoftohet për vendimin mbi përshtatshmërinë shëndetësore për ushtrimin e funksionit të kontrollit të trafikut ajror.

Bazuar në këtë email dhe Vendimit si dhe takimit të realizuar me AMA, departamenti i SHNA-së ka marrë informatat se kontrollori i trafikut ajror me nr. të Licencës CAA 033, pas realizimit të të gjitha hapave

shëndetësore ka rezultuar se mund të i ushtroj privilegjet e Kontrollorit të Trafikut Ajror si dhe do të pajiset me certifikate mjekësore të klasës 3.

Si rrjedhojë, Departamenti i SHNA-së ka pranuar kërkesën së bashku me dokumentacionin e nevojshëm nga ASHNA me datë 05.10.2023, për rikthimin në detyrë të kontrollorit me Nr. Licencës CAA 033, fillimisht duke realizuar hapat e paraparë në Tabelën 12.1, pika 2(b) të UTP-së.

Pas analizimit të këtyre dokumenteve dhe sqarimeve të dhëna, Departamenti i SHNA-së ka njoftuar ASHNA-në se mund të vazhdojnë me hapat e paraparë në UTP, Tabela 12.1, pika 2(b) dhe ka kërkuar që dëshmitë e gjeruara me këtë rast të dërgohen në AAC-e, për të proceduar tutje me hapat e shfuqizimit të Vendimit 05/ZDP/VE/2023, dhe ri-lëshimit të miratimeve APS dhe APP për licencën me numër CAA033.

Këto dëshmi ASHNA i ka dërguar me datë 09.10.2023, dhe pas rishikimit të këtyre dëshmimeve dhe dokumentacioneve relevante departamenti i SHNA-së ka vërejtur se janë plotësuar kushte e parapara në Tabelën 12.1, pika 2(b) të UTP-së.

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në pajtim me nenet 15.1 (d) dhe (j), 37 dhe 39.1 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28, Viti III, datë 4 qershor 2008), ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, me Shtojcën II, piken ATCO.AR.D.005 të Rregullores (AAC) nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontroloreve të trafikut ajror, dhe Vendimit me datë 09.10.2023 nr. Prot. 2023/DSF/AMS/GEN/340 nga AMA, rekomandimit të Departamentit të SHNA-së, ka vendosur si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim mbi mjetin juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të ngrit kontest administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.


Arianit Islami
Zv. Drejtor i Përgjithshëm

